

UNIVERSITETI I PRISHTINES

ABSTRAKT

PROGRAMI I STUDIMEVE : Fakulteti Juridik “PROGRAMI JURIDIKO – FINANCIAR”

KADIDATJA : Gentiana Gashi

MENTOR : Prof.Dr.Agim Paca

TITULLI I TEMES: SISTEMI BANKAR DHE PUNET BANKARE.

Punimi i temës master me titull “SISTEMI BANKAR DHE PUNET BANKARE” të kandidatës Gentiana Gashi është hartuar në 56 faqe.Punimi ndahet në 5 kapituj.

Ne kapitullin e I - të – “Hyrje” – fillimisht njihemi me definicionin e bankave dhe me historikun e zhvillimit të bankave.

Ne kapitullin e II – të – “Bankat” është dhënë një vështrim i përgjithshëm mbi përkufizimin e bankave. Pra bankat merren me dy grupe themelore të punëve financiare të bankës sic janë : punët e formimit te parave dhe punët e ndërmjetësimit financiar.Në këtë kapitull është bërë edhe një klasifikim i ndarjes së llojeve të bankave në : *Banka qëndrore, Bankat depozitare – komerciale, Bankat afariste, Bankat investive, Bankat universale, Bankat hipotekare, Bankat regjionale dhe banka per zhvillim etj.* Si dhe është folur për rolin dhe funksionin e secilës vec e vec.

Në kapitullin e III-të – “Institucionet financiare jo bankare” - flitet per Institucionet Financiare Jo Bankare, rolin , veqoritë dhe funksionin e tyre. Institucionet financiare jo bankare sipas funksionimit te tyre i ndajmë në:*Institucionet financiare depozitare, Investitoret institucional,Instituciont investive financiare.*

Gjithashtu u ceken edhe nëndarjet e secilës prej tyre.

Në Kapitullin e IV-të – “Burimet e mjeteve të bankave”- flitet për Burimet e mjeteve të Bankave të cilat I klasifikojmë në dy grupe *Burimet depozitare të mjeteve bankare dhe Burimet jo depozitare të mjeteve bankare.*

Në kapitullin e V-të – “Punët Bankare” flitet për Punët Bankare , perkufizimi I tyre si dhe për klasifikimin e punëve bankare I cili mund të bëhet në bazë të kriterëve të ndryshme. Egzistojnë kriterë të ndryshme për klasifikimin e punëve bankare,por kriteret më të rëndësishme janë : *Sipas parimit analitik, Sipas parimit funksional dhe Sipas afatit.*

Fjalet kyçe : Bankat, punët bankare , institucionet financiare jo bankare , burimet e mjeteve të bankave.